| 50  | 177 | SAMI SHABAN QARRI        | 3+1 | 105.1 | DURRËS | ISHËM       | 3,090,000 | 18,601.95 | 1,897.80 |
| 51  | 203 | HASAN SULEJMAN MEZINI    | 2+1 | 80    | DURRËS | ISHËM       | 2,470,000 | 18,601.95 | 1,897.80 |
| 52  | 23  | NAUN MIHAL RROQJA        | 2+1 | 80    | DURRËS | RAJONI 4    | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 53  | 2   | MELE HAKI SHUTINA        | 2+1 | 80    | DURRËS | RAJONI 5    | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 54  | 6   | PETRIT HAMID UKU         | 3+1 | 105.1 | DURRËS | RAJONI 5    | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 55  | 10  | SEIT RAMADAN KURTI       | 1+1 | 70    | DURRËS | RAJONI 5    | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 56  | 4   | FATMIR QAMIL AHMETI      | 2+1 | 80    | DURRËS | RAJONI 6    | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 57  | 15  | MERTTA ALI KEQI          | 1+1 | 70    | DURRËS | RAJONI 6    | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 58  | 27  | GJERGJ ZENEL LAMÇELLARI  | 2+1 | 80    | DURRËS | RAJONI 6    | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 59  | 29  | BESNIK AQIF KRRASHI      | 1+1 | 70    | DURRËS | RAJONI 6    | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 60  | 40  | RAHIM MET METI           | 2+1 | 80    | DURRËS | RAJONI 6    | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 61  | 41  | MILAIM MIFTAR GJONI      | 3+1 | 105.1 | DURRËS | RAJONI 6    | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 62  | 45  | KUJTIM MEHMET GJINDIAJ   | 3+1 | 105.1 | DURRËS | RAJONI 6    | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 63  | 1   | HANE RIZA MERKULAJ       | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 64  | 7   | ALI SEIT SHAHINI         | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 65  | 9   | GEN'TJAN MUSTAFA VRIONI  | 3+1 | 105.1 | DURRËS | KATUND I RI | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 66  | 10  | ILMI RAMIZ HASBARDHI     | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 67  | 11  | LIZE PJETER FRROKU       | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 68  | 14  | AZEM MEHMET LLULLA       | 3+1 | 105.1 | DURRËS | KATUND I RI | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 69  | 17  | NDUE GJOK VUKSANI        | 3+1 | 105.1 | DURRËS | KATUND I RI | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 70  | 18  | RAMAZAN VELI BICARI      | 3+1 | 105.1 | DURRËS | KATUND I RI | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 71  | 23  | ABDYL MUHAMED VERIONI    | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 72  | 26  | BILBIL AZEM MATRANXHI    | 1+1 | 70    | DURRËS | KATUND I RI | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 73  | 27  | LUMTURIJE RAMADAN CYRBJA | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 74  | 33  | PELLUMB XHEMALI DACI     | 3+1 | 105.1 | DURRËS | KATUND I RI | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 75  | 34  | ZEF PRENG PALUCA         | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 76  | 36  | AGRON HASAN BERISHA      | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 77  | 39  | HATIXHE HASAN ZAKO       | 1+1 | 70    | DURRËS | KATUND I RI | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 78  | 40  | ASTRIT RUSTEM BAFITIA    | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 79  | 41  | BEDRI KAMBER GASHI       | 3+1 | 105.1 | DURRËS | KATUND I RI | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 80  | 45  | MUSTAFA QAZIM SHALA      | 3+1 | 105.1 | DURRËS | KATUND I RI | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 81  | 46  | THELLEZA SALI DERVISHI   | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 82  | 47  | RIZA HALIL GASHI         | 1+1 | 70    | DURRËS | KATUND I RI | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 83  | 50  | SAMI ABDYLMIN MURRA      | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 84  | 51  | BASHKIM REFIK VERJONI    | 1+1 | 70    | DURRËS | KATUND I RI | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 85  | 53  | ZYLYF SELIM KUÇI         | 2+1 | 80    | DURRËS | KATUND I RI | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 86  | 7   | ALEKSANDER VELI KOKA     | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 87  | 18  | VENETIKE MURAT TAFILI    | 1+1 | 70    | DURRËS | SUKTH       | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 88  | 27  | KAFIJE KURTISH XHURXHI   | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 89  | 31  | VJOLLCA IBRAHIM NANI     | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 90  | 36  | DOD GJON DEDA            | 1+1 | 70    | DURRËS | SUKTH       | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 91  | 48  | REXHEP ALI JAKUPI        | 1+1 | 70    | DURRËS | SUKTH       | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 92  | 54  | PJETER ZEF KUCAJ         | 2+1 | 80    | DURRËS | SUKTH       | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 93  | 55  | MEVLUD ADIL KURTASHI     | 1+1 | 70    | DURRËS | SUKTH       | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 94  | 56  | RUFAT ALI KURTASHI       | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 95  | 57  | DITURI HAXHI DEMCOLLI    | 2+1 | 80    | DURRËS | SUKTH       | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 96  | 58  | AGIM TEFIK MULLAJ        | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 97  | 65  | GJERGJINA GEZIM KLARI    | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 98  | 70  | SALI BAJRAM HASA         | 2+1 | 80    | DURRËS | SUKTH       | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 99  | 76  | KORAB REXHEP HODA        | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 100 | 82  | XHEMAL NEXHIP XHAKOLLI   | 1+1 | 70    | DURRËS | SUKTH       | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 101 | 88  | NEXHBEDIN SELMAN ZIBA    | 3+1 | 105.1 | DURRËS | SUKTH       | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 102 | 91  | FEHMI RUFAT KURTASHI     | 1+1 | 70    | DURRËS | SUKTH       | 2,100,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 103 | 93  | ISMET NEXHBEDIN ZIBA     | 2+1 | 80    | DURRËS | SUKTH       | 2,400,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |
| 104 | 2   | XHEMAL DALIP SKORA       | 3+1 | 105.1 | DURRËS | RRASHBULL   | 3,000,000 | 15,924.83 | 1,897.80 |

**VENDIM****Nr. 749, datë 9.12.2021****PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS SË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT DHE CAKTIMIN E INSTITUTIT TË NDËRTIMIT SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit, me vlerë të plotë, në masën 68 930 414 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e katërmbydhjetë) lekë, pa TVSH.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim” 01110, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” shtohet fondi prej 13 786 083 (trembëdhjetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e tre) lekësh pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit.

3. Instituti i Ndërtimit caktohet si njësi zbatuese për zbatimin e projektit të rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Instituti i Ndërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM****Nr. 750, datë 9.12.2021****PËR KALIMIN TE BASHKIA KRUIJË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin te Bashkia Krujë të 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) apartamenteve në 13 (trembëdhjetë) njësitë e banimit në ndërtesa (pallat), në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**



| Bashkia Krujë – Njësia Administrative Thumanë ZRZH - paketa A |            |                                |                                        |                                    |                            |                        |                             |         |         |                    |
|---------------------------------------------------------------|------------|--------------------------------|----------------------------------------|------------------------------------|----------------------------|------------------------|-----------------------------|---------|---------|--------------------|
| Nr .                                                          | Emërtime t | Sipërfaq e totale objekti (m²) | Vlera e objektit sipas kontratës (All) | Kostoja mesatare ndërtimi (All/m²) | Sipërfaqe shërbimes h (m²) | Sipërfaq e banimi (m²) | Tipologjitë e apartamenteve |         |         |                    |
|                                                               |            |                                |                                        |                                    |                            |                        | Ap. 1+1                     | Ap. 2+1 | Ap. 3+1 | TOTAL APARTAMENT E |
| 1                                                             | Objekti 01 | 2,353.0                        | 79,279,488.65                          | 33,692.94                          | 588.00                     | 1,765.00               | 0                           | 18      | 0       | 18                 |
| 2                                                             | Objekti 02 | 2,353.0                        | 79,279,488.65                          | 33,692.94                          | 588.00                     | 1,765.00               | 0                           | 18      | 0       | 18                 |
| 3                                                             | Objekti 03 | 2,353.0                        | 79,279,488.65                          | 33,692.94                          | 588.00                     | 1,765.00               | 0                           | 18      | 0       | 18                 |
| 4                                                             | Objekti 05 | 2,707.0                        | 91,206,789.53                          | 33,692.94                          | 690.00                     | 2,017.00               | 0                           | 0       | 18      | 18                 |
| 5                                                             | Objekti 06 | 784.0                          | 26,415,265.24                          | 33,692.94                          | 196.00                     | 588.00                 | 0                           | 6       | 0       | 6                  |
| 6                                                             | Objekti 07 | 1,738.8                        | 58,585,284.68                          | 33,692.94                          | 409.80                     | 1,329.00               | 12                          | 6       | 0       | 18                 |
| 7                                                             | Objekti 08 | 1,738.8                        | 58,585,284.68                          | 33,692.94                          | 410.80                     | 1,328.00               | 12                          | 6       | 0       | 18                 |
| 8                                                             | Objekti 09 | 1,789.2                        | 60,283,408.88                          | 33,692.94                          | 447.30                     | 1,341.90               | 6                           | 3       | 6       | 15                 |
| 9                                                             | Objekti 10 | 1,738.8                        | 58,585,284.68                          | 33,692.94                          | 409.80                     | 1,329.00               | 12                          | 6       | 0       | 18                 |
| Totali                                                        |            | 17,555.6                       | 591,499,783.65                         | 303,236.46                         | 4,327.70                   | 13,227.90              | 42                          | 81      | 24      | 147                |

| Bashkia Krujë – Njësia Administrative Thumanë ZRZH - paketa B |            |                                |                                        |                                  |                            |                        |                             |         |         |                    |
|---------------------------------------------------------------|------------|--------------------------------|----------------------------------------|----------------------------------|----------------------------|------------------------|-----------------------------|---------|---------|--------------------|
| Nr .                                                          | Emërtime t | Sipërfaq e totale objekti (m²) | Vlera e objektit sipas kontratës (All) | Kosto mesatare ndërtimi (All/m²) | Sipërfaqe shërbimes h (m²) | Sipërfaq e banimi (m²) | Tipologjitë e apartamenteve |         |         |                    |
|                                                               |            |                                |                                        |                                  |                            |                        | Ap. 1+1                     | Ap. 2+1 | Ap. 3+1 | TOTAL APARTAMENT E |
| 1                                                             | Objekti 11 | 2115                           | 71,520,615.29                          | 33,815.89                        | 481.00                     | 1,634.00               | 6                           | 6       | 6       | 18                 |
| 2                                                             | Objekti 12 | 1052                           | 35,574,320.23                          | 33,815.89                        | 240.00                     | 812.00                 | 3                           | 3       | 3       | 9                  |
| 3                                                             | Objekti 13 | 2115                           | 71,520,615.29                          | 33,815.89                        | 481.00                     | 1,634.00               | 6                           | 6       | 6       | 18                 |
| 4                                                             | Objekti 14 | 7780                           | 263,087,653.40                         | 33,815.89                        | 1,556.00                   | 6,224.00               | 15                          | 25      | 28      | 68                 |
| Totali                                                        |            | 13,062.0                       | 441,703,204.21                         | 135,263.58                       | 2,758.00                   | 10,304.00              | 30                          | 40      | 43      | 113                |

**VENDIM****Nr. 751, datë 9.12.2021**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës

që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)**

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da’esh) DHE AL-QAIDA:**

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;

**Emraan Ali**

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.



## VENDIM

Nr. 752, datë 9.12.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E  
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË  
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN,  
PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE  
SHFUQIZIMIN E MASAVE  
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,  
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, e të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Pika 3, e kreut I, të vendimit nr. 1128, datë 30.12.2020, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2016/1693, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër ISIL dhe Al-Qaeda dhe individëve, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me to”, të ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2018/1000, (CFSP) 2019/271, (CFSP) 2019/1944, (CFSP) 2020/1126, (CFSP) 2020/1516, (CFSP) 2021/613 dhe (CFSP) 2021/1825, sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 153/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Arben Ahmetaj**



### ANEKSI 3

#### VENDIMET E KËSHILLIT (CFSP) 2016/1693

Të Datës 20 Shtator 2016

**Lidhur me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaidës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me ta dhe shfuqizimin e Pozicionit të Përbashkët 2002/402 / CFSP**

KUNSHILLI I BASHKIMI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e

Sigurisë, Ndërsa:

- (1) Më 19 Tetor 2001, Këshilli Evropian deklaroi se ishte i vendosur për të luftuar terrorizmin në çdo formë në të gjithë botën dhe se do të vazhdojë përpjekjet e tij për të forcuar koalicionin e bashkësisë ndërkombëtare për të luftuar terrorizmin në çdo formë dhe përmasë.
- (2) Më 16 janar 2002, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ('KS i Sigurimit') miratoi Rezolutën 1390 (2002) ('UNSCR 1390 (2002)') e cila zgjeroi masat e vendosura nga Rezolutat 1267 (1999) të KS të KB ('UNSCR 1267 (1999)') dhe 1333 (2000) ('UNSCR 1333 (2000)') për të mbuluar Usama bin Laden dhe anëtarët e organizatës Al-Kaeda dhe individë të tjerë, grupe, ndërmarrje dhe subjekte të lidhura me to, siç u përcaktua nga Komiteti i krijuar në përputhje me RKSKB 1267 (1999).
- (3) RKSKB 1390 (2002) rregullon fushën e sanksioneve në lidhje me ngrirjen e fondeve, ndalimin e vizave dhe embargon për furnizimin, shitjen ose transferimin e armëve, si dhe për këshillat teknike, ndihmën ose trajnimin në lidhje me aktivitetet ushtarake të vendosura nga UNSCR 1267 (1999) dhe UNSCR 1333 (2000).
- (4) UNSCR 1390 (2002) u miratua nga Këshilli i Sigurimit të KB në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila lejon KS të KB të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.
- (5) Këto masa, të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të KB në kontekstin e luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar, janë transferuar në ligjin e së drejtës së Unionit me Qëndrim të Përbashkët 2002/402 / CFSP (\*), miratuar nga Këshilli në kuadrin e Politikave të Përbashkëta të Jashtme dhe Sigurisë të Bashkimit dhe nga Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 881/2002 (\*).
- (6) Më 17 Dhjetor 2015, Këshilli i Sigurimit i KB miratoi Rezolutën 2253 (2015) ('UNSCR 2253 (2015)') duke zgjeruar fushën e masave të vendosura nga RKSKB 1390 (2002) për individët, grupet, ndërmarrjet ose entitetet e lidhura me Shtetin Islamik në Irak dhe Levant ('ISIL (Da'esh)') dhe duke përsëritur dënimin e tij të qartë ndaj ISIL (Da'esh), Al-Kaidës dhe individëve, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me të për akte të vazhdueshme dhe të shumta terroriste kriminale që synojnë shkaktimin e vdekjeve të civilëve të paafajshëm dhe viktimave të tjera, shkatërrimin e pronës dhe dëmtimin e madh të stabilitetit.
- (7) Në atë kontekst, RKSKB 2253 (2015) rritet se sanksionet në mbështetje të luftës kundër terrorizmit janë një mjet i rëndësishëm në ruajtjen dhe rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe kujtoi që ISIL (Da'esh) është një grup i copëtuar i Al-Kaidës dhe se çdo individ, grup, ndërmarrje ose entitet që mbështet ISIL (Da'esh) është i kategorizuar për t'u renditur nga Kombet e Bashkuara ('KB').

(1) Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2002/402 / CFSP i datës 27 Maj 2002 lidhur me masat kufizuese kundër anëtarëve të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaida, dhe individëve të tjerë, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me to (OJ L 139, 29.5.2002, f. 4).

(2) Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 881/2002 e datës 27 Maj 2002 që imponon masa të raktuara kufizuese të drejtuara kundër





personave të caktuar dhe entiteteve të lidhura me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda (OJ L 139, 29.5.2002, f.9).

- (8) ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda përfaqësojnë një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Masat kufizuese të miratuara nga Bashkimi Evropian në kontekstin e luftës kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaidës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me ta, janë pjesë e objektivave të Politikës së Përbashkët të Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë së Unionit siç përcaktohet në nenin 21 (2) (c) të Traktatit.
- (9) Në funksion të kërcënimit të paraqitur nga ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda, Këshilli duhet të jetë në gjendje të vendosë masa kufizuese me synim të qartë për çdo individ pavarësisht nga kombësia ose shtetësia, ose nga çdo entitet përgjegjës për veprimet terroriste në emër ose në mbështetje të ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim.
- (10) Qëllimi i masave të tilla të synuara është të parandalojnë veprimet në emër ose në mbështetje të ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda.
- (11) Është e nevojshme të parashikohen kufizime për hyrjen dhe tranzitin nëpër territoret e Shteteve Anëtare nga ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda dhe nga persona të lidhur me ta, duke përfshirë edhe ata që janë shtetas të një Shteti Anëtar. Pa paragjykuar përgjegjësitë e Shteteve Anëtare për ruajtjen e sigurisë së brendshme, kufizime të tilla nuk duhet të parandalojnë që shtetasit e caktuar të një Shteti Anëtar të kalojnë tranzit përmes një Shteti tjetër Anëtar në mënyrë që të kthehen në Shtetin Anëtar të kombësisë së tyre, dhe as nuk duhet të parandalojnë anëtarët e caktuar të familjes së shtetasit të një Shteti Anëtar nga kalimi tranzit përmes një Shteti tjetër Anëtar për të njëjtin qëllim.
- (12) RKSKB 1373 (2001) parashikon që aty ku Shtetet Anëtare të KB kanë identifikuar persona ose subjekte si të përfshirë në veprime terroriste, duhet të merren masat e duhura.
- (13) Në të njëjtën kohë, masat që zbatohen RKSKB 1267 (1999), 1390 (2002) dhe 2253 (2015) si ligj i Unionit duhet të ndryshohen për të pasqyruar dispozitat e rezolutave përkatëse të KS të KB.
- (14) Në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, kur Këshilli vendos të përfshijë emrin e një personi ose entiteti në listë në Aneks, ai duhet të japë arsyje individuale, specifike dhe konkrete për ta bërë këtë, dhe një vendim i tillë duhet të merret mbi një bazë faktike mjaft të fortë.
- (15) Për hir të qartësisë dhe sigurisë ligjore masat kufizuese të vendosura nga Qëndrimi i Përbashkët 2002/402 / CFSP të ndryshuar nga Vendimet pasuese duhet të konsolidohen në një instrument të ri ligjor dhe të përfshijnë dispozita që lëjojnë Këshillin të vendosë masa kufizuese ndaj personave dhe njësive.
- (16) Qëndrime të Përbashkëta 2002/402 / CFSP duhet të shfuqizohet dhe të zëvendësohen me këtë Vendim.
- (17) Nevojiten veprime të mëtejshme nga Bashkimi Evropian për të zbatuar masa të caktuara.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

#### Neni 1

1. Furnizimi direkt ose indirekt, shitja, transferimi ose eksporti i armëve ose materialeve të ngjashme të të gjitha llojeve, duke përfshirë armët dhe municionet, automjetet ushtarake dhe pajisjet, pajisjet paramilitare dhe pjesët e tyre të këmbimit rezervë, për çdo individ, grup, ndërmarrje ose entitet të caktuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në përputhje me Rezolutat 1267 (1999), 1333 (2000) dhe 2253 (2015), siç janë përditësuar nga Komiteti i krijuar në përputhje me Rezolutën 1267 (1999) ("Komiteti"), ose i caktuar nga Këshilli, ose nga ata që veprojnë në emër të tyre ose nën drejtimin e tyre, nga shtetas të Shteteve Anëtare ose nga apo përmes territoreve të Shteteve Anëtare ose duke përdorur anijet ose avionët e tyre me flamur, duhet të ndalohen nëse janë me origjinë apo jo në territoret e tyre.

2. Duhet të ndalohet të

(a) sigurohet ndihmë teknike, shërbime ndërmjetësimi dhe shërbime të tjera që lidhen me aktivitetet ushtarake

dhe me sigurimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e armëve apo materialit përkatës të të gjitha llojeve, duke përfshirë armët dhe municionet, automjetet dhe pajisjet ushtarake, pajisjet paraushtarake, si edhe pjesë këmbimi për të lartpërmendurat, drejtpërdrejt ose indirekt për çdo individ, grup, ndërmarrje ose entitet të

përmendur

në

paragrafin

1;

të



(b) sigurojë financim ose ndihmë financiare në lidhje me aktivitetet ushtarake, duke përfshirë në veçanti grante, hua dhe sigurimin e kredisë së eksportit, si dhe sigurimin dhe risigurimin e garantuar për çdo shitje, furnizim, transferim ose eksport të armëve dhe materialeve të lidhura me to, ose për sigurimin e ndihmës teknike përkatëse, shërbimeve të ndërmjetësimit dhe shërbimeve të tjera drejtpërdrejtë ose indirekt për çdo individ, grup, ndërmarrje ose entitet të përmendur si në paragrafin 1;

(c) marrin pjesë me vetëdije dhe qëllimisht në aktivitate objekti ose efekti i të cilave është të anashkalojë ndallimet e përmendura në pikën (a) ose (b) të këtij paragrafi.

#### Neni 2

1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen, ose tranzitin nëpër territoret e tyre të personave, sic është përcaktuar dhe që u nënshtrohen kufizimeve të udhëtimit nga Këshilli i Sigurimit të KB në përputhje me Rezolutat e UNSCR 1267 (1999), 1333 (2000) dhe 2253 (2015) ose nga Komiteti, identifikuar si:

(a) pjesëmarrja në financimin, planifikimin, lehtësimin, përgatitjen ose kryerjen e akteve ose aktiviteteve duke, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të tij, ose në mbështetje të;

(b) furnizimi, shitja ose transferimi i armëve dhe materialeve të lidhura me të;

(c) rekrutimi për, ose përndryshe mbështetja e akteve ose aktiviteteve të

Al-Kaidës, ISIL (Da'esh), ose ndonjë qelizë, filial partner, grupi i copëtuar ose derivat i saj; ose

(d) duke u kontrolluar direkt ose indirekt nga, ose përndryshe duke mbështetur, çdo individ, grup, ndërmarrje ose entitet që ka lidhje me Al-Kaidën ose ISIL (Da'esh), të përfshirë në ISIL (Da'esh) dhe në Listën e Sanksioneve të Al-Kaidës.

2. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen në, apo transit përmes, territoret e tyre të personave:

(a) i lidhur me ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaidën apo ndonjë qelizë, filialin, fraksion ose derivat i tij, duke përfshirë edhe nga:

(i) marrë pjesë në financimin e ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaidës ose ndonjë qelizë, partnere, grupi copëzues ose derivat i saj, ose në financimin e akteve ose aktiviteteve nga, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të tyre;

(ii) pjesëmarrja në planifikimin, lehtësimin, përgatitjen ose kryerjen e akteve ose aktiviteteve apo sigurimin ose marrjen e trajnimit terrorist siç janë udhëzimet në lidhje me armët, pajisjet shpërthyes ose metoda apo teknologji të tjera me qëllim të kryerjes së akteve terroriste nga, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, filial partner, grupi copëzues ose derivat të tij;

(iii) angazhimi në tregti me ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose çdo qelizë, filial, grupim i ndarë ose derivat i tij, në veçanti i naftës, produkteve të naftës, rafinerive modulare dhe materialit të lidhur me të, si dhe tregtia me burlime të tjera natyrore dhe tregtia në pasurinë kulturore;

(iv) furnizimi, shitja ose transferimi i armëve dhe materialeve të lidhura me ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, filial, grupi i copëtuar ose derivat i tyre;

(b) udhëtimi ose kërkimi i udhëtimit jashtë Bashkimit me qëllim të:

(i) kryerjes, planifikimit, apo përgatitjes, ose pjesëmarrjes në akte terroriste në emër të ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose ndonjë qelizë, bashkëpunëtor, grupimi të ndarë ose derivat të tyre;

(ii) sigurimin ose marrjen e trajnimit terrorist, në emër ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, partnere, grupimi të ndarë ose derivat të tij; ose

(iii) përndryshe mbështetjen ISIL (Da'esh), Al-Kaidën ose ndonjë qelizë, filial, grupim të ndarë ose derivat të saj;

(c) duke kërkuar të udhëtojnë në Bashkimin Europian për të njëjtin qëllim siç referohet në pikën (b) ose të marrë pjesë në akte ose aktivitete në lidhje me, nën emrin e, në emër ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose ndonjë qelizë, filial, grupimi të ndarë ose derivat të saj;



- (d) rekrutimi për, ose përndryshe mbështetja e akteve ose aktiviteteve të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose ndonjë qelize, bashkëpunëtorë, grupimi copëzues ose derivati të tyre, duke përfshirë:
- (i) sigurimin ose mbledhjen, me çdo mjet, drejtpërdrejt ose indirekt, të fondeve me qëllim që të financojë udhëtimin e individëve, për qëllimin e përmendur në pikat (b) dhe (c); organizimin e udhëtimit të individëve për qëllimet e përmendura në pikat (b) dhe (c), ose përndryshe lehtësimin e tij për atë qëllim;
  - (ii) duke kërkuar një person tjetër për të marrë pjesë në akte ose aktivitete duke, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose ndonjë celule, filial, grupim i copëtuar ose derivati të tij;
- (e) nxitja ose provokimi publikisht i akteve ose aktiviteteve, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë celule, partnere, grupimi të copëtuar ose derivati të tij, duke përfshirë nisur nga inkurajimi ose glorifikimi i akteve ose aktiviteteve të tilla duke shpikuar kështu rrezik që të kryhen akte terroriste;
- (f) duke qenë i përfshirë ose bashkëpunëtor në urdhërimin ose kryerjen e abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë rrëmbimin, përdhunimin, dhunën seksuale, martesën e detyruar dhe skllavërimin e personave, jashtë territorit të Bashkimit Europian, në interes ose në emër të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë celule, bashkëpunëtorë, grupimi të copëtuar ose derivati të tij,
- sic renditet në Aneks.
3. Paragrafi 1 dhe 2 nuk duhet të detyrojnë një Shtet Anëtar të refuzojë hyrjen e shtetasve të tij në territorin e tij.
4. Paragrafi 1 nuk do të zbatohet kur hyrja ose tranziti është i nevojshëm për përmbushjen e një procesi gjyqësor, ose kur Komiteti përcakton se hyrja ose tranziti është i justifikuar.
5. Shtetet Anëtare mund të japin përfashtime nga masat e vendosura në paragrafin 2, kur udhëtimi është i justifikuar:
- (a) në bazë të një nevojë urgjente humanitare;
  - (b) për qëllime të një procesi gjyqësor; ose
  - (c) kur një Shtet Anëtar është i detyruar nga një detyrim ndaj një organizate ndërkombëtare.
6. Një Shtet Anëtar që dëshiron të bëjë përfashtimet e përmendura në paragrafin 5 duhet të njoftojë Këshillin me shkrim. Në lidhje me pikat (a) dhe (b) të paragrafit 5, përfashtimi do të konsiderohet i dhënë nëse një ose më shumë anëtarë të Këshillit nuk paraqesin një kundërshtim me shkrim brenda dy ditëve të punës nga marrja e njoftimit të përfashtimit të propozuar. Nëse një ose më shumë anëtarë të Këshillit ngrenë një kundërshtim, Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, mund të vendosë të dëktojë përfashtimin e propozuar.
7. Kur, në përputhje me paragrafin 5, një Shtet Anëtar autorizon hyrjen, ose tranzitin përmes territorit të tij të personave të renditur në Shtet, autorizimi do të kufizohet në qëllimin për të cilin ai është dhënë dhe për personat e interesuar prej tij.

### Neni 3

1. Të gjitha fondet, pasuritë e tjera financiare dhe burimet ekonomike, të zotëruara ose të kontrolluara, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga persona, grupe, ndërmarrje dhe subjekte të caktuara dhe që i nënshirohen ngrirjes së aseteve nga Këshilli i Sigurimit të KB në përputhje me Rezolutat 1267 (1999), 1333 (2000) dhe 2253 (2015), ose nga Komiteti, i identifikuar si:
- (a) pjesëmarrja në financimin, planifikimin, lehtësimin, përgatitjen ose kryerjen e akteve ose aktiviteteve nga, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të;
  - (b) furnizimi, shitja ose transferimi i armëve dhe materialit të lidhur me të;
  - (c) rekrutimi për, ose përndryshe mbështetja e akteve ose aktiviteteve të
- Al-Kaidës, ISIL (Da'esh), ose ndonjë celule, partnere, grupimi të copëtuar ose derivati të tij; ose
- (d) duke qenë në prapësi ose kontrolluar drejtpërdrejt ose indirekt nga, ose duke mbështetur ndryshe, çdo individ, grup, ndërmarrje ose entitet të lidhur me ISIL (Da'esh) ose Al-Kaeda, të përfshirë në ISIL (Da'esh) dhe Lista e Sanksioneve të Al-Kaidës, ose nga një palë e tretë që vepron në emër të tyre ose sipas udhëzimit të tyre, do të ngrihet.



2. Asnjë fond, mjete të tjera financiare ose burime ekonomike nuk do të vihen në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi për ose për të mirën e personave fizikë ose juridikë të përmendur në paragrafin 1.

3. Të gjitha fondet, mjetet e tjera financiare dhe burimet ekonomike, të zotëruara ose të kontrolluara direkt ose indirekt, nga persona, grupe, ndërmarrje dhe subjekte të:

(a) lidhur me ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, filial, grup copëzues ose derivat i tyre, duke përfshirë:

(i) pjesëmarrjen në financimin e ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, bashkëpunëtor, grup i copëtuar ose derivat i saj, ose në financimin e akteve ose aktivitetëve nga, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të tyre, ose në mbështetje të tyre;

(ii) pjesëmarrja në planifikimin, lehtësimin, përgatitjen ose kryerjen e akteve ose aktivitetëve ose sigurimin ose marrjen e trajnimit terrorist siç janë udhëzimet në lidhje me armët, pajisjet shpërthyes ose metoda ose teknologji të tjera me qëllim të kryerjes së akteve terroriste nga, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda ose ndonjë qelize, partnere, grupimi të ndarë ose derivatit të tij;

(iii) angazhimi në tregti me ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, filial, grup grupimi të ndarë ose derivatit të tij, në veçanti i naftës, produkteve të naftës, rafinerive modulare dhe materialeve të lidhura me të, si edhe tregtia me burime të tjera natyrore dhe tregtia në pasurinë kulturore;

(iv) furnizimi, shitja ose transferimi i armëve dhe materialeve të lidhura me ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, filial, grupimi të ndarë ose derivatit të tij;

(b) udhëtimi ose kërkimi i udhëtitit jashtë Bashkimit për qëllime të:

(i) kryerjes, planifikimit, apo përgatitjes, ose pjesëmarrjes në akte terroriste në emër ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose ndonjë qelize, bashkëpunëtor, grupimi të ndarë ose derivatit të tij;

(ii) sigurimin ose marrjen e trajnimit terrorist, në emër ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë qelize, partnere, grupimi të ndarë ose derivatit të tij; ose

(iii) përndryshe mbështesin ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë qelizë, filial, grupimi të ndarë ose derivatit të tij;

(c) duke kërkuar të udhëtojë në Bashkimin Europian për qëllimin e përmendur në pikën (b) ose të marrë pjesë në akte ose aktivitete në lidhje me, nën emrin e, në emër ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose çdo qelizë, filial, grupimi të ndarë ose derivatit të tij;

(d) rekrutimi për ose mbështetjen e veprimeve ose veprimeve të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose ndonjë qelizë, filial, grupimi të ndarë ose derivatit të tyre, duke përfshirë:

(i) siguruar ose mbledhur, me çdo mjet, drejtpërdrejt ose indirekt, fonde në mënyrë që të financojë udhëtimet e individëve, për qëllimin e përmendur në pikat (b) dhe (c); organizimin e udhëtitit të individëve për qëllimin e përmendur në pikat (b) dhe (c), ose përndryshe lehtësimin e tij për atë qëllim;

(ii) duke i kërkuar një personi tjetër për të marrë pjesë në akte ose aktivitete duke, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda, ose ndonjë qelizë, filial, grupimi të ndarë ose derivatit të tij;

(e) nxitja ose provokimi i akteve ose aktivitetëve publike, në bashkëpunim me, nën emrin e, në emër të, ose në mbështetje të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose ndonjë qelize, partnere, grupimi të ndarë ose derivatit të tij, duke përfshirë nga inkurajimi ose glorifikimi i akteve ose aktivitetëve të tilla duke shkaktuar kështu rrezik që të kryhen akte terroriste;

(f) duke qenë i përfshirë ose bashkëpunëtor në urdhërimin ose kryerjen e abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë rrëmbimin, përdhunimin, dhunën seksuale, martesën e detyruar dhe skllavërimin e personave, jashtë territorit të Bashkimit, në emër ose në emër të ISIL (Da'esh), Al-Kaeda ose çdo qelizë, bashkëpunëtor, grupim i ndarë ose derivatit të tij.

siç është renditur në Aneks, do të ngrihen.

4. Asnjë fond, mjete të tjera financiare ose burime ekonomike nuk do të vihen në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi për ose për të mirën e personave fizikë ose juridikë të përmendur në paragrafin 3.



5. Me anë të shëmbjes nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, përjashtimet mund të të bëhen për fonde, mjete financiare dhe burime ekonomike të cilat janë: të

- (a) nevojshme për shpenzimet themelore, përfshirë pagesën për produktet ushqimore, qirarë ose hipotekën, ilaçet dhe trajtimin mjekësor, taksat, primet e sigurimit dhe tarifën e shërbimeve publike;
- (b) të destinuara ekskluzivisht për pagesa për tarifa të arsyeshme profesionale dhe rimbursim të shpenzimeve të bëra që lidhen me ofrimin e shërbimeve ligjore në përputhje me ligjet kombëtare; ose të
- (c) destinuara ekskluzivisht për pagesa për tarifën ose tarifën e shërbimit, në përputhje me ligjet kombëtare, për mbajtjen ose mirëmbajtjen rutinë të fondeve të ngrira, aseteve/aktiveve të tjera financiare dhe burimeve ekonomike.

Këto përjashtime do të bëhen vetëm pasi të njoftohet nga Komiteti Shtet Anëtar i interesuar, kur është e përshatshme, për qëllimin për të autorizuar hyrjen në fonde të tilla, aktive të tjera financiare ose burime ekonomike dhe në mungesë të një vendimi negativ nga Komiteti brenda tre ditët e njoftimit të tillë.

6. Me përjashtim nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, përjashtimet mund të bëhen gjithashtu për fondet, pasuritë financiare dhe burimet ekonomike të cilat janë të nevojshme për shpenzime të jashtëzakonshme me kusht që një përcaktim i tillë të jetë njoftuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të Komiteti, kur është e zbatueshme, dhe është aprovuar nga Komiteti.

7. Paragrafi 3 nuk do të parandalojë një person ose entitet të caktuar të bëjë një pagesë për shkak të një kontrate të lidhur përpara listës së një personi ose entiteti të tillë, me kusht që Shteti Anëtar përkatës të ketë përcaktuar që pagesa nuk është marrë direkt ose indirekt nga një person ose njësi ekonomike e përmendur në paragrafët 1 dhe 3.

8. Nëpërmjet shëmbjes nga paragrafi 3, autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar mund të autorizojnë lëshimin e fondeve të caktuara të ngrira ose burimeve ekonomike me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) fondet ose burimet ekonomike janë subjekt të një vendimi arbitrazhi të dhënë para datës në të cilën personi fizik ose juridik, entiteti ose organi i përmendur në paragrafin 3 ishte renditur në Aneks, i një vendimi gjyqësor ose administrativ të dhënë në Bashkim, ose një vendimi gjyqësor të ekzekutueshëm në Anëtar Shtet përfitues, para, në ose pas asaj date;
- (b) fondet ose burimet ekonomike do të përdoren ekskluzivisht për të kënaqur pretendimet e siguruar me një vendim të tillë ose të njohura si të vlefshme në një vendim të tillë, brenda kufijve të përcaktuar nga ligjet dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë të drejtat e personave që kanë pretendime të tilla;

(c) vendimi nuk është në dobi të një personi fizik ose juridik, entiteti ose organi të renditur në Shtojcë; dhe

(d) njohja e vendimit nuk është në kundërshtim me politikën publike në shtetin anëtar në fjalë.

Shteti anëtar në fjalë duhet të informojë shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin për çdo autorizim të dhënë sipas këtij paragrafi.

9. Paragrafët 2 dhe 4 nuk do të zbatohen për shtimin e pagesave në llogaritë e ngrira të personave dhe subjekteve të përmendura në paragrafët 1 dhe 3 me kusht që pagesa të vllë të jenë të ngrira.

#### Neni 4

Asnjë kërkesë, duke përfshirë pretendimet për kompensim ose ndonjë pretendim tjetër të këtij lloji, të tilla si një kërkesë për shlyerje ose një kërkesë me kusht nën një garanci, në lidhje me ndonjë kontratë ose transaksion, performancë e të cilit është prekur, drejtpërdrejt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht, për shkak të masave të vendosura në përputhje me Rezolutat e UNSCA 1267 (1999), 1333 (2000) dhe 2253 (2015), duke përfshirë masat e Bashkimit Europian ose të çdo Shteti Anëtar në përputhje me, siç kërkohet nga ose në ndonjë lidhje me, zbatimin e vendimeve përkatëse të Këshillit të Sigurimit të KB ose masat e mbuluara nga ky vendim, do t'u jepen personave ose entiteteve të përcaktuara nga KB ose të listuara në Aneks ose çdo personi ose entiteti që pretendon përmes ose për të mirën e ndonjë personi të tillë apo entiteti.

#### Neni 5

1. Këshilli, duke vepruar me unanimitet, mbi një propozim të një Shteti Anëtar ose nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Europian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, duhet të hartojnë e vendosin listën në Aneks dhe të miratojnë modifikimet përkatëse.



2. Këshilli duhet t'i komunikojë vendimin e përmendur në paragrafin 1, duke përfshirë deklaratën e arsyeve, personit fizik ose juridik, grupit, ndërmarrjes dhe njësisë ekonomike në fjalë, ose drejtpërdrejt, nëse dihet adresa, ose përmes publikimit të një njoftimi, duke i siguruar personit fizik ose juridik, grupit, ndërmarrjes ose njësisë ekonomike një mundësi për të paraqitur vëzhgime.

3. Kur paraqiten vëzhgime, ose kur paraqiten prova të reja thelbësore, Këshilli duhet të rishikojë vendimin e përmendur në paragrafin 1 dhe duhet të informojë personin fizik ose juridik, grupin, ndërmarrjen ose entitetin përkatës në përputhje me rrethanat.

4. Me përjashtim nga paragrafi 1, nëse një Shtet Anëtar konsideron se ka pasur një ndryshim thelbësor të rrethanave që ndikojnë në përcaktimin e një personi ose entiteti të listuar, Këshilli, duke vepruar me një shumicë të cilësuar mbi një propozim nga ai Shtet Anëtar, mund të vendosë për të hequr emrin e personit ose entitetit të tillë nga lista në Aneks.

#### Neni 6

1. Ky Vendim do të rishikohet, ndryshohet ose shfuqizohet sipas rastit, veçanërisht në dritën e vendimeve përkatëse nga Këshilli i Sigurimit të KB ose nga Komiteti.

2. Masat e referuara në Nenin 2 (2) dhe Nenin 3 (3) dhe (4) do të rishikohen në intervale të rregullta dhe të paktën çdo 12 muaj.

3. Kur vëzhgimet dorëzohen nga një person ose entitet i caktuar në përputhje me nenin 2 (2) ose nenin 3 (3) dhe (4), Këshilli do të rishikojë përcaktimin në dritën e atyre vëzhgimeve dhe masat do të pushojnë së zbatuari nëse Këshilli përcakton, në përputhje me procedurën e përmendur në Nenin 5, që kushtet për zbatimin e tyre nuk plotësohen më.

4. Nëse bëhet një kërkesë e mëtejshme, bazuar në prova thelbësore të reja, për të hequr një person ose entitet nga Aneksi, Këshilli do të kryejë një rishikim të mëtejshëm në përputhje me paragrafin 3.

5. Masat e referuara në Nenin 2 (2) dhe Nenin 3 (3) dhe (4) do të zbatohen deri më 23 shtator 2017.

#### Neni 7

Qëndrimi i Përbashkët 2002/402 / CFSP shfuqizohet dhe zëvendësohet me këtë Vendim.

#### Neni 8

Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën pas botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, 20 shtator 2016.

*Për Këshillin*  
Presidenti  
I. KORČOK

#### ANEKS

Lista e personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të përmendura në Nenin 2 dhe 3



16.7.2018

EN

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 178 I/3

**VENDIME****VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2018/1000****i datës 16 Korrik 2018**

**që ndryshon Vendimin (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me to**

| 136 | Ferdinand Plaku                                                                                                                                                                                    | Moravë | arë | 2723 | 1106/14             |  |  |  | 2977 | 1702   | 203 | 345,506   |  |  |  |         | 345,506   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shprehjen nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                                                                                       |
| 137 | Mançe Plaku                                                                                                                                                                                        | Moravë | arë | 2723 | 1106/15             |  |  |  | 1153 | 775.6  | 203 | 157,446.8 |  |  |  | 123,000 | 280,446.8 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shprehjen nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                                                                                       |
| 138 | Dritan Shehu                                                                                                                                                                                       | Moravë | arë | 2723 | 1106/51;<br>1106/50 |  |  |  | 2820 | 110    | 203 | 22,330    |  |  |  |         | 22,330    | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shprehjen nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. | Vendoset barrë hipotekore në favor të Drejtorisë Rajonale Të Tërmëqësuesit e Mëdhenj. |
| 139 | Besnik Plaku                                                                                                                                                                                       | Moravë | arë | 2723 | 1106/52             |  |  |  | 1080 | 1080   | 203 | 219,240   |  |  |  | 292,500 | 511,740   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shprehjen nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                                                                                       |
| 140 | Albert Meçaj,<br>Valentina Meçaj                                                                                                                                                                   | Moravë | arë | 2723 | 1106/48             |  |  |  | 1360 | 1360   | 203 | 276,080   |  |  |  | 35,700  | 311,780   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shprehjen nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                                                                                       |
| 141 | Behar Plaku                                                                                                                                                                                        | Moravë | arë | 2723 | 1106/49             |  |  |  | 1734 | 1651   | 203 | 335,153   |  |  |  | 66,000  | 401,153   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shprehjen nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                                                                                       |
| 142 | Luljeta Plaku,<br>Anila Plaku,<br>Elca Plaku,<br>Flamur Plaku                                                                                                                                      | Moravë | arë | 2723 | 1106/68             |  |  |  | 2100 | 1556.8 | 203 | 316,030.4 |  |  |  |         | 316,030.4 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shprehjen nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                                                                                       |



|     |                                                                                                                                                                                                              |          |     |      |         |  |  |  |        |        |     |           |  |  |        |           |                                                                           |                              |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-----|------|---------|--|--|--|--------|--------|-----|-----------|--|--|--------|-----------|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
|     | Xhemijet Plaku                                                                                                                                                                                               |          |     |      |         |  |  |  |        |        |     |           |  |  |        |           | 5.8.2021.                                                                 |                              |
| 143 | Eduard Plaku                                                                                                                                                                                                 | Moravë   | arë | 2723 | 1106/69 |  |  |  | 36     | 36     | 203 | 7,308     |  |  |        | 7,308     | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 144 | Anjan Hatija                                                                                                                                                                                                 | Moravë   | arë | 2723 | 1106/19 |  |  |  | 3513   | 3217.5 | 203 | 653,152.5 |  |  | 14,000 | 667,152.5 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 145 | Xhemil Hatia                                                                                                                                                                                                 | Moravë   | arë | 2723 | 1106/20 |  |  |  | 1936   | 1405   | 203 | 285,215   |  |  | 26,000 | 311,215   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 146 | Besnik Plaku                                                                                                                                                                                                 | Moravë   | arë | 2723 | 1106/71 |  |  |  | 2742.5 | 875    | 203 | 177,625   |  |  | 81,000 | 258,625   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 147 | Saimir Hatija                                                                                                                                                                                                | Moravë   | arë | 2723 | 1106/22 |  |  |  | 1144   | 234.7  | 203 | 47,644.1  |  |  | 37,500 | 85,144.1  | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 148 | Agush Hatia                                                                                                                                                                                                  | Moravë   | arë | 2723 | 1106/23 |  |  |  | 3827   | 417    | 203 | 84,651    |  |  |        | 84,651    | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 149 | Gazmend Hasllari, Refet Xhafer Hasllari                                                                                                                                                                      | Moravë   | arë | 2723 | 1106/73 |  |  |  | 1700   | 185.9  | 203 | 37,737.7  |  |  |        | 37,737.7  | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 150 | Eduard Lavdani                                                                                                                                                                                               | Moravë   | arë | 2723 | 1106/53 |  |  |  | 3715   | 309.1  | 203 | 62,747.3  |  |  |        | 62,747.3  | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. | Në favor të Alpha Bank sh.a. |
| 151 | Albana Sherraj                                                                                                                                                                                               | Moravë   | arë | 2723 | 1106/27 |  |  |  | 1533   | 278.4  | 203 | 56,515.2  |  |  | 46,500 | 103,015.2 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 152 | Lavdimir Plaku                                                                                                                                                                                               | Moravë   | arë | 2723 | 1106/29 |  |  |  | 1621   | 25     | 203 | 5,075     |  |  | 13,200 | 18,275    | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 153 | Rrapo Xhafa                                                                                                                                                                                                  | Lapardha | arë | 2831 | 1104/12 |  |  |  | 4960   | 14     | 203 | 2,842     |  |  |        | 2,842     | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 154 | Rysem Xhafa                                                                                                                                                                                                  | Lapardha | arë | 2831 | 1104/11 |  |  |  | 4100   | 434    | 203 | 88,102    |  |  |        | 88,102    | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 155 | Minusha Muharem Xhafa, Mico Hysni Xhafa, Avari Hysni Xhafa, Rudina Hysni Ferracaku, Oliver Hysni Xhafa, Selvi Hysni Beqsha, Lumtur Hysni Bilçari, Bajame Hysni Hazizi, Rustem Hysni Xhafa, Ajije Hysni Myrto | Lapardha | arë | 2831 | 1104/10 |  |  |  | 6000   | 1858.5 | 203 | 377,275.5 |  |  |        | 377,275.5 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 156 | Fatjon Ata                                                                                                                                                                                                   | Lapardha | arë | 2831 | 1104/9  |  |  |  | 4925   | 1507   | 203 | 305,921   |  |  |        | 305,921   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |
| 157 | Jani Xhafa, Xhemil Xhafa, Kadri Xhafa, Rahime Jak                                                                                                                                                            | Lapardha | arë | 2831 | 1104/8  |  |  |  | 1750   | 538    | 203 | 109,214   |  |  |        | 109,214   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shkresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |                              |



|        |                |          |     |      |         |  |  |  |         |        |     |            |  |  |            |           |                                                                           |
|--------|----------------|----------|-----|------|---------|--|--|--|---------|--------|-----|------------|--|--|------------|-----------|---------------------------------------------------------------------------|
| 158    | Xhevdar Xhafa  | Lapardha | arë | 2831 | 1104/7  |  |  |  | 6010    | 1790   | 203 | 363,370    |  |  |            | 363,370   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 159    | Myslym Xhafa   | Lapardha | arë | 2831 | 1104/6  |  |  |  | 5292    | 1749   | 203 | 355,047    |  |  |            | 355,047   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 160    | Artif Xhafa    | Lapardha | arë | 2831 | 1104/5  |  |  |  | 1658    | 506    | 203 | 102,718    |  |  |            | 102,718   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 161    | Egrem Rrapi    | Lapardha | arë | 2831 | 1104/4  |  |  |  | 3297    | 1104.5 | 203 | 224,213.5  |  |  | 45,000     | 269,213.5 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 162    | Vasil Prifti   | Lapardha | arë | 2831 | 1104/3  |  |  |  | 2500    | 830.5  | 203 | 168,591.5  |  |  | 28,800     | 197,391.5 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 163    | Vladimir Rrapi | Lapardha | arë | 2831 | 1104/35 |  |  |  | 1000    | 322    | 203 | 65,366     |  |  | 25,000     | 90,366    | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 164    | Niko Rrapi     | Lapardha | arë | 2831 | 1104/34 |  |  |  | 1200    | 447.9  | 203 | 90,923.7   |  |  | 28,000     | 118,923.7 | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 165    | Vangjel Rrapi  | Lapardha | arë | 2831 | 1104/33 |  |  |  | 1200    | 392    | 203 | 79,576     |  |  |            | 79,576    | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 166    | Gëzim Rrapi    | Lapardha | arë | 2831 | 1104/32 |  |  |  | 3855    | 1470   | 203 | 298,410    |  |  | 27,000     | 325,410   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 167    | Jorgo Prifti   | Lapardha | arë | 2831 | 1104/37 |  |  |  | 1000    | 328    | 203 | 66,584     |  |  | 60,000     | 126,584   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 168    | Simon Prifti   | Lapardha | arë | 2831 | 1104/36 |  |  |  | 3105    | 1046   | 203 | 212,338    |  |  |            | 212,338   | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| 169    | Ajet Hasllari  | Moravë   | arë | 2723 | 1106/74 |  |  |  | 1270    | 209    | 203 | 42,427     |  |  |            | 42,427    | Konfirmuar nga DVASHK-ja Berat, me shëresën nr. 2510/2, më datë 5.8.2021. |
| Totali |                |          |     |      |         |  |  |  | 434,340 |        |     | 74,223,464 |  |  | 26,869,635 | 8,027,700 | 109,595,139                                                               |

**VENDIM****Nr. 755, datë 9.12.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E  
DOKUMENTACIONIT, TË  
PROCEDURAVE E TË KRITEREVE PËR  
KRYERJEN E INSPEKTIMEVE  
SHTETËRORE TË SISTEMIT TË  
ARSIMIT DHE FORMIMIT  
PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:****I. PJESA E PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e dokumentacionit, të procedurave e të kriterëve për kryerjen e inspektimit në sistemin e arsimit dhe formimit profesional (në vijim “AFP”) në Shqipëri.

2. Inspektimi i ofruesve publikë dhe jopublikë të AFP-së bazohet në këto parime:

- a) parimi i pavarësisë;
- b) parimi i programimit të inspektimeve;
- c) parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit;
- ç) parimi i dispozitës më të favorshme ligjore;
- d) parimi i informimit të publikut dhe mbrojtjes së konfidencialitetit.

3. Objekt i inspektimit, sipas këtij vendimi, janë të gjithë ofruesit publikë dhe jopublikë të AFP-së në Republikën e Shqipërisë.

**II. NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR INSPEKTIMIN**

4. Njësia përgjegjëse për inspektimin e ofruesve të AFP-së është sipas pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

5. Me qëllim përmirësimin e sistemit arsimor profesional, njësia përgjegjëse:

- a) informon AKAFPK-në dhe AKPA-në lidhur me raportet e inspektimit dhe gjetjet nga inspektimet e kryera pranë ofruesve publikë dhe jopublikë të AFP-së, me qëllim garantimin e cilësisë në proceset e vetëvlerësimit, akreditimit, monitorimit e licencimit;

- b) bashkërendon veprimtarinë me AKPA-në për vlerësimin e jashtëm të sigurimit të cilësisë së ofruesve privatë të licencuar për ofrimin e kurseve afatshkurtra të të nxëniet gjatë gjithë jetës.

**III. PROCEDURAT, DOKUMENTACIONI DHE KRITERET E INSPEKTIMIT**

6. Ministri përgjegjës për AFP-në:

- a) miraton planin vjetor të njësise përgjegjëse për inspektimet në AFP;
- b) fillon me kërkesë apo kryesisht procedurën e inspektimit të paplanifikuar në planin vjetor të njësise përgjegjëse për inspektimin;
- c) përcakton objektivat afatmesëm të inspektimit;
- ç) i rekomandon subjektit përmirësimin e situatës në bazë të gjetjeve të inspektimit.

7. Inspektimi i ofruesve të AFP-së është në katër lloje:

- a) inspektim i orientuar;
- b) inspektim tematik;
- c) inspektim i plotë;
- ç) inspektim i detyrave të lëna.

8. Inspektimi i orientuar nënkupton një inspektim specifik për një proces konkret të veprimtarisë së ofruesve të AFP-së, për të cilin ka një ankesë apo ka informacion për shkelje të legjislacionit për arsimin profesional. Inspektimi i orientuar është i paplanifikuar.

9. Inspektimi tematik është i planifikuar dhe synon kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin e fushave të caktuara të funksionimit të ofruesit të AFP-së, të cilat konsiderohen përparësi për politikën e AFP-së.

10. Inspektimi i plotë nënkupton vlerësimin e jashtëm, tërësor të veprimtarisë së ofruesit të AFP-së. Inspektimi i plotë mbështetet në raportin e vetëvlerësimit të ofruesit të AFP-së.

11. Inspektimi i plotë për ofruesit e AFP-së, në rastin kur përfshihet dhe inspektimi i aspekteve të kulturës së përgjithshme, realizohet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin.

12. Inspektim i detyrave të lëna (rekomandimeve) nënkupton inspektimin e rekomandimeve përkatëse dhe detyrave të lëna për përmirësimin e situatës pas inspektimeve të mëparshme.

13. Inspektimet kryhen me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-në. Në rastet kur inspektimi realizohet sipas pikës 11, të këtij vendimi,



inspektimi kryhet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe ministrit përgjegjës për arsimin. Në urdhrin e ministrit përcaktohen:

- a) subjekti që do të inspektohet;
- b) lloji i inspektimit;
- c) afati për përfundimin e inspektimit;
- ç) periudha për të cilën do të kryhet inspektimi.

14. Dokumentet e procedurës së inspektimit janë sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

15. Njësia e inspektimit:

- a) përgatit programin e inspektimit, i cili miratohet nga eprori i tij drejtpërdrejtë;
- b) përgatit raportin e inspektimit;
- c) përgatit planin vjetor të njësisë përgjegjëse për inspektimet në AFP dhe e dërgon për miratim te ministri.

16. Në hartimin e planit vjetor të inspektimit kanë përparësi subjektet:

a) të cilat janë konstatuar me shkelje gjatë inspektimeve të mëparshme;

b) të cilave u janë lënë rekomandime për përmirësimin e situatës nga inspektime të mëparshme;

c) të cilat kanë arritje krahasimisht të ulëta të nxënësve/kursantëve lidhur me programet që ofruesit e AFP-së ofrojnë, por dhe të arritjeve të ulëta të nxënësve në provimet e maturës shtetërore profesionale.

17. Në ushtrimin e inspektimit, njësia inspektimit:

a) kryen hetim të plotë administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative;

b) kërkon dhe merr nga subjektet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;

c) inspekton dosjet dhe çdo dokument lidhur me administrimin e veprimtarisë së ofruesve të AFP-së.

18. Ministri përgjegjës për AFP-në urdhëron subjektin e inspektimit për të korrigjuar shkeljet e

konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë provat që e vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim sipas pikës 12, të këtij vendimi.

19. Në rast të moszbatimit të rekomandimeve të dhëna, sipas pikës 18, të këtij vendimi, në mënyrë të përsëritur, ministri përgjegjës për AFP-në mund të vendosë mbylljen e një ofruesi të AFP-së, kur nuk respektohen kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “e”, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

#### IV.DISPOZITA TRANZITORE DHE T FUNDIT

20. Ministria përgjegjëse për AFP-në, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ngarkohet të marrë masat e nevojshme, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, për shtimin e njësisë përgjegjëse për inspektimin në strukturën dhe organikën e ministrisë.

21. Ngarkohet ministria përgjegjëse për AFP-në për miratimin e rregullores së brendshme të detajuar të punës për inspektimin në fushën e AFP-së, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

22. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe ofruesit e AFP-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj



## SHTOJCË I



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
NJËSIA E INSPEKTIMIT TË SISTEMIT TË ARSIMIT PROFESIONAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

## URDHËR

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

## PËR FILLIMIN E INSPEKTIMIT ...

Në bazë dhe për zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM-së “Për dokumentacionin, procedurat dhe kriteret për kryerjen e inspektimeve shtetërore të sistemit të arsimit dhe formimit profesional”

Për këtë arsye,

## URDHËROJ:

1. Nisjen e inspektimit, me temë: \_\_\_\_\_.
2. Inspektimi të kryhet nga data \_\_\_\_\_ deri më datë \_\_\_\_\_ nga inspektorët Z/Znj. \_\_\_\_\_.
3. Periudha që do të inspektohet fillon në datën \_\_\_\_\_ deri në datën \_\_\_\_\_.
4. Të kërkohet nga subjekti \_\_\_\_\_ gjithë dokumentacioni i nevojshëm.
5. Relacioni i përgatitur t’i paraqitet drejtuesit të njësisë së inspektimit të sistemit të arsimit profesional për vazhdimin e procedimit, brenda afatit të mësipërm.
6. Të merren masat për njoftimin e subjektit që do t’i nënshtrohet inspektimit, në përputhje me nenin 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

MINISTRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
NJËSIA E INSPEKTIMIT TË SISTEMIT TË ARSIMIT PROFESIONAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot.      Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

**Lënda:** *Njoftim mbi fillimin e inspektimit*

**Drejtuar:** Subjektit \_\_\_\_\_

*I nderuar Z/ Znj.*

Ju njoftojmë se Ministria ..... do të nisë procesin e inspektimit .....

**MINISTRI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
NJËSIA E INSPEKTIMIT TË SISTEMIT TË ARSIMIT PROFESIONAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot.      Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

**MIRATOHET**

**Ministri**

**Drejtuar:** Ministri

**Nëpërmjet:**

**Përgatiti:**

**Lënda:** Relacioni paraprak i inspektimit për subjektin \_\_\_\_\_

**Data:**

*I/E nderuar Z/ Znj. Ministër,*

Bazuar në urdhrin e ministrit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, në përfundim të inspektimit rezultoi:

**i. inspektimi**

**ii. analiza**

**iii. konkluzionet**

Inspektori/ët:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
NJËSIA E INSPEKTIMIT TË SISTEMIT TË ARSIMIT PROFESIONAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

**MIRATOHET****Ministri****Drejtuar:** Ministrit**Nëpërmjet:****Përgatiti:****Lënda:** Relacioni përfundimtar i inspektimit për subjektin \_\_\_\_\_**Data:***i/e nderuar Z./Znj. Ministër,*

Bazuar në urdhrin e ministrit në përfundim të të cilit rezultoi:

- i. inspektimi
- ii. analiza
- iii. shqyrtimi i observacioneve
- iv. konkluzionet
- v. rekomandimet

Inspektori/ët:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
NJËSIA E INSPEKTIMIT TË SISTEMIT TË ARSIMIT PROFESIONAL

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

**Lënda: Rekomandime** \_\_\_\_\_

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të inspektimit, në përfundim të procedurës së inspektimit,

**VËREJ SE:**

Përmbledhje e shkurtër e inspektimit \_\_\_\_\_

**Për këto arsye,**

bazuar në nenin 26, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 18 dhe 19 të VKM-së “Për dokumentacionin, procedurat dhe kriteret për kryerjen e inspektimeve shtetërore të sistemit të arsimit dhe formimit profesional”,

**Rekomandoj:****Ministri****VENDIM****Nr. 756, datë 9.12.2021****PËR SISTEMIN E NJOHJES SË TË  
NXËNIT TË MËPARSHËM JOFORMAL  
DHE INFORMAL**

Në mbështetje të nenit 100 të dhe të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:****I. PJESA E PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave për njohjen e të nxënimit të mëparshëm joformal dhe informal për arritjen e kualifikimeve profesionale në nivelet 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), me përjashtim të kualifikimeve që lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë, niveli 5, KSHK.

2. Përveç parimeve të përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, sistemi i njohjes së të nxënimit të mëparshëm joformal dhe informal mbështetet edhe në parimet e mëposhtme:

a) e drejta individuale, e cila përfshin procesin e njohjes së të nxënimit të mëparshëm, është zgjedhje vullnetare e individit;

b) besueshmëria, e cila konsiston në proces, procedura dhe kriteret për njohjen e të nxënimit joformal dhe informal, i cili duhet të jetë i drejtë,

transparent dhe i mbështetur në mekanizmat e sigurimit të cilësisë;

c) aksesit i barabartë dhe trajtim i drejtë, si një sistem i njohjes së të nxënimit të mëparshëm joformal dhe informal, që duhet të respektojë interesat legjitime të kandidatëve, si dhe të garantojnë pjesëmarrje të balancuar e trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët.

3. Sistemi i njohjes së të nxënimit të mëparshëm joformal dhe informal përfshin:

a) procesin e akreditimit të ofruesit të arsimit dhe formimit profesional (në vijim “AFP”) për njohjen e të nxënimit të mëparshëm joformal dhe informal;

b) njohjen e të nxënimit të mëparshëm nga ofruesit e AFP-së të akredituar, nëpërmjet dhënies së një kualifikimi në formën e një certifikate.

**II. INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE PËR  
SISTEMIN E NJOHJES SË TË NXËNIT TË  
MËPARSHËM JOFORMAL DHE INFORMAL**

4. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e procesit të njohjes së të nxënimit të mëparshëm (në vijim “NJNM”) joformal dhe informal janë:

a) ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, që miraton procedurat e rregulloret e njohjes së të nxënimit të mëparshëm;

b) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;

c) Agjencia e Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;

ç) ofruesit e AFP-së të akredituar si njohës të të nxënimit të mëparshëm joformal dhe informal.

5. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional harton politikat e përgjithshme për njohjen e të nxënimit të mëparshëm joformal e informal.



6. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, me qëllim funksionimin e sistemit të njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal e informal:

a) propozon udhëzimin për procedurat e vlerësimit e të certifikimit, sipas pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

b) akrediton ofruesit e AFP-së si njohës të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal, sipas shkronjës “k”, të pikës 3, të vendimit nr. 673, datë 16.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”.

7. Agjencia e Kombëtare për Punësim dhe Aftësi bashkëpunon e ndihmon ofruesit AFP-së të akredituar për njohjen e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal:

a) duke identifikuar e orientuar kandidatë potencialë nga punëkërkuessit e papunë për sistemin e njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal;

b) duke vendosur në dispozicion burimet e nevojshme për procesin e njohjes së të nxënit të mëparshëm për institucionet publike ofruese të AFP-së të akredituara si ofrues të njohjes së të nxënit të mëparshëm, sipas shkronjës “ç”, të pikës 3, të vendimit nr. 554, datë 31.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi”.

8. Ofruesit e AFP-së të akredituar për njohjen e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal kanë për detyrë:

a) të ofrojnë informacion për të gjitha fazat e procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të publikimeve zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;

b) të ofrojnë informacion për mundësitë e plotësimit të kualifikimit, në rastet kur, në përfundim të procesit, konstatohet se kandidati e ka të nevojshëm përvetësimin e disa rezultateve të të nxënit;

c) të mbajnë një regjistër të veçantë të arritjeve të çdo kandidati dhe të të certifikuarve nëpërmjet procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal;

ç) të raportojnë rregullisht tek Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, sipas instrumenteve të përcaktuara për ecurinë e procesit të NJNM-së joformal dhe informal;

d) të zbatojnë procedurat për njohjen e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal.

### III. SISTEMI I NJOHJES SË TË NXËNIT TË MËPARSHËM JOFORMAL DHE INFORMAL

9. Njohja e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal realizohet vetëm nga ofrues të AFP-së të akredituar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

10. Ofruesit e akredituar për njohjen e të nxënit të mëparshëm janë institucione të AFP-së, sipas përkufizimit të pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, me kapacitetet e nevojshme, që përmbushin standardet e akreditimit për procesin e njohjes së të nxënit të mëparshëm.

11. Strukturat përgjegjëse të ofruesit të AFP-së së akredituar për njohjen e të nxënit të mëparshëm, në zbatimin e procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal, janë:

a) koordinatori, i cili është përgjegjës për administrimin e zbatimit e procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal;

b) eksperti këshillues, i cili informon e orienton kandidatët për procesin në tërësi dhe në të gjitha fazat e veçanta;

c) eksperti vlerësues i fushës përkatëse profesionale, i cili verifikon dëshmitë e të nxënit individual dhe vlerëson nëse këto përputhen me standardet.

12. Ekspertët e jashtëm për ofruesit publikë të akredituar përzgjidhen sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

13. Procesi i njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal përfundon me dhënien e certifikatës për nivelin përkatës të KSHK-së dhe bazohet në procesin e vlefshmërisë, i cili përfshin 4 (katër) faza:

a) identifikimin;

b) dokumentimin;

c) vlerësimin;

ç) certifikimin e rezultateve të të nxënit.

14. Procedura e vlerësimit të rezultateve të të nxënit, sipas shkronjës “c”, të pikës 13, të këtij vendimi, realizohet sipas pikave 1 dhe 2, të nenit



28, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara në standardet e kualifikimeve profesionale të niveleve 2, 3, 4 dhe 5, të KSHK-së.

15. Ofruesit e AFP-së të akredituar të njohjes së të nxënit të mëparshëm arkivojnë të gjithë dokumentacionin lidhur me procesin e njohjes.

16. Njohja e të nxënit realizohet në përputhje me procedurat e vlerësimit e të certifikimit, të cilat përfshijnë procedurat e vlerësimit dhe të ankimimit, sigurimin e cilësisë, akreditimin e ofruesve të njohjes e të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal, procedurat e ankimimit, administrimit, si dhe tarifat e aplikuara për kandidatët e procesit të njohjes së të nxënit joformal dhe informal, si dhe për institucionet që aplikojnë për akreditim, të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin profesional, sipas pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

17. Ngarkohen Ministra e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, si dhe institucionet ofruese të AFP-së të akredituara për njohjen e të nxënit të mëparshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

## VENDIM

**Nr. 757, datë 9.12.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 620, DATË 22.10.2021,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E KUSHTEVE, PËR  
VENDOSJEN E DETYRIMIT TË  
SHËRBIMIT PUBLIK NDAJ TË  
LICENCUARVE NË SEKTORIN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE, GJATË  
GJENDJES SË EMERGJENCËS NË  
FURNIZIMIN ME ENERGJI  
ELEKTRIKE DHE PËR PËRBALLIMIN  
E PARANDALIMIN E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 620, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun IV bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Shoqëria e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Për qëllime të furnizimit me të gjitha sasi të nevojshme për nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal, shoqëria e prodhimit e ngarkuar me



detyrimin e shërbimit publik ka të drejtë të marrë me qira asete gjeneruese termike të energjisë, të shkëmbejë/të depozitojë apo të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë.

Shoqëria publike e prodhimit të energjisë organizon një procedurë të posaçme konkurruese, me afat të përsheptuar për marrjen me qira të aseteve gjeneruese termike të energjisë me afat deri në tri vite, sipas procedurave të përcaktuara në kreun VIII, të këtij vendimi.

Ndërmjet Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në lidhje me sasinë e energjisë së nevojshme për furnizimin e të gjithë klientëve universalë dhe çmimin për njësi, sipas burimit të energjisë. Shoqëria publike e prodhimit, në bazë të kontratës, lëshon ndaj furnizuesit të shërbimit publik çdo muaj faturën për koston përkatëse të prodhimit të energjisë nga burimet e veta, nga asetet e marra me qira dhe/ose blerja e energjisë.

Për efekt të këtij vendimi, Furnizuesi i Shërbimit Universal dërgon te prodhuesi publik i energjisë programe mujore, javore dhe ditore për mbulimin e kërkesës me energji elektrike për klientët fundorë. Shoqëria publike e prodhimit kryen veprime shitjeje energjie dhe depozitimi/shkëmbimi vetëm pasi plotëson të gjitha nevojat e furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal.”.

b) Pika 2 shfuqizohet.

2. Në kreun VIII bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Titulli i kreut ndryshohet dhe zëvendësohet me “PROCEDURA E MARRJES ME QIRA TË ASETEVE GJENERUESE DHE SHKËMBIMIT/DEPOZITIMIT TË ENERGJISË NGA PRODHUESI PUBLIK I ENERGJISË”.

b) Pas pikës 11 shtohen pikat 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16, me këtë përmbajtje:

“12. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë për nevoja të sigurimit të gjithë energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve universalë, kryen procedurë të posaçme konkurruese për marrjen me qira të aseteve gjeneruese termike të energjisë për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

13. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë hap procedurën konkurruese duke bërë njoftim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në *website-in* e saj dhe në një gazetë ndërkombëtare. Afati i hapjes së

aplikimeve është jo më pak se 7 (shtatë) ditë nga botimi në gazetën ndërkombëtare.

14. Kriteret e kualifikimit të ofruesve në procedurën e posaçme konkurruese të zhvilluar nga shoqëria, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacioni ligjor mbi të drejtat e përdorimit apo të pronësisë së asetit gjenerues që ofrohet për dhënien me qira;

b) Kapaciteti prodhues i asetit;

c) Dokumentacioni për gjendjen teknike të asetit, rendimentin e prodhimit, specifikimet e lëndës djegëse, konsumin nominal dhe treguesit e ndotjes mjedisore;

ç) Garancia për aftësinë gjeneruese të sigurt dhe pa ndërprerje të asetit;

d) Deklarata për rendimentin në prodhim të asetit gjenerues të ofruar;

dh) Deklarata për dhënien e garancisë së lidhjes së asetit në sistemin e transmetimit 220 KV të Republikës së Shqipërisë.

15. Shoqëria e prodhimit përcakton në procedurën e qiramarrjes një sistem vlerësimi për ofertën fituese, i cili bazohet kryesisht mbi çmimin më të ulët të qirasë së ofruar si dhe, ndër të tjera, por pa u kufizuar në:

a) eficiencën në gjenerim të asetit;

b) emetimet e gazrave serë;

c) kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.

16. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë bën publike gjithë dokumentacionin dhe ofertat fituese në faqen zyrtare të internetit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë dhe shoqëritë KESH sh.a., OSHEE Group sh.a. dhe OST sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj



**VENDIM**  
**Nr. 758, datë 9.12.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**  
**NR. 253, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT**  
**TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E**  
**PLANIT TË KONSOLIDIMIT**  
**FINANCIAR TË SEKTORIT PUBLIK,**  
**ELEKTROENERGJETIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “E”, të seksionit IV, e të pikës 22, të shtojcës, që i bashkëlidhet marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, ratifikuar me ligjin nr. 170/2014, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Të dhënat e tabelës 6 “Reduktimi i humbjeve të rishikuara dhe synimet për grumbullimin e të ardhurave/arkëtimeve”, të kreut IV, të tekstit të planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergetik, që i bashkëlidhet vendimit nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave,

zëvendësohen me të dhënat në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a., OSHEE Group sh.a, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Enti Rregullator i Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

|      | <b>Humbjet totale (%)</b> | <b>Mbledhja e të ardhurave (%)</b> |
|------|---------------------------|------------------------------------|
| 2014 | 37.8                      | 91.9                               |
| 2015 | 31.3                      | 98.3                               |
| 2016 | 28.0                      | 92.0                               |
| 2017 | 26.4                      | 97.0                               |
| 2018 | 23.9                      | 95.0                               |
| 2019 | 21.8                      | 95.0                               |
| 2020 | 21.5                      | 95.0                               |
| 2021 | 20.5                      | 95.0                               |
| 2022 | 19.6                      | 95.0                               |
| 2023 | 19.0                      |                                    |
| 2024 | 18.5                      |                                    |
| 2025 | 18.1                      |                                    |
| 2026 | 17.8                      |                                    |

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë